




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	19.04.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1183/18
PËR/ZA/TO:	znj. Jehona HYSENI, u.d. Menaxhere e Zyrës së Prokurimit – Komuna e Gjilanit
CC:	z. Lutfi HAZIRI, Kryetar i Komunës së Gjilanit
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizim me aparat fotokopjues, printer dhe skaner për të gjitha njësitë shpenzuese në Komunën e Gjilanit "

E nderuara znj. HYSENI,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " **Furnizim me aparat fotokopjues, printer dhe skaner për të gjitha njësitë shpenzuese në Komunën e Gjilanit** ", me numër të prokurimit: 651-18-2220-121, dhe me nr. të brendshëm: GI 651-18-020-121, Agjencia Kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Furnizim me aparat fotokopjues, printer dhe skaner për të gjitha njësitë shpenzuese në Komunën e Gjilanit** ", me numër të prokurimit: 651-18-2220-121, dhe me nr. të brendshëm: GI 651-18-020-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 19.04.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-1183/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Furnizim me aparat fotokopjues, printer dhe skaner për të gjitha njësitë shpenzuese në Komunën e Gjilanit*", me numër të prokurimit: *651-18-2220-121*, dhe me nr. të brendshëm: *GI 651-18-020-121*, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi** ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike kornizë të llojit furnizim, me vlerë të mesme prej 93.250,00 €. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka vërejtur se tek rubrika *III.2.4. kapaciteti teknik dhe profesional tek kërkesa 1, Autoriteti Kontraktues, ka kërkuar nga Operatorët ekonomik të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar me sukses së paku një furnizim të ngjashëm gjatë tri viteve të fundit (2014,2015 dhe 2016)*. Kërkesë kjo për të cilën AKK konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik më saktësisht me nenin 69.

Bazuar në dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në nenin 69 paragrafi 2.1. parashihet se për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të Operatorëve ekonomik, Autoritetet Kontraktuese mund të kërkojnë " listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë ".

Pra në këtë rast do duhej të kërkohej lista e kontratave bashkangjitur si dëshmi referencat mbi përfundimin e kontratave **të ngjashme të furnizimeve realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë.**

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë Operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizimet e ngjashme.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 69 Kapaciteti teknik/profesional të Ligjit për prokurimin publik nr. 04/L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

